

Sektori i veprave penale të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në përputhje me nenin 68 paragrafi (5) nga Rregullorja gjyqësore dhe neni 31 nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut (“Gazeta Zyrtare e RMV” nr.14/2022 të datës 20 janar 2022), në seancë duke vepruar sipas Rekomandimit të Byrosë për përfaqësimin e RMV për lëndën *Transkop SHA Manastir kundër RMV*, A.nr.48057/12, nga 01 prill 2021 për respektimin e parimit të barazisë së mjeteve dhe principit të kontradiktës së procedurës penale nga neni 6 paragrafi (1) të KEDNJ, më 31.01.2022, nxori:

KONKLUZION

Principi i gjykimit të drejtë nënkupton të drejtën për mbajtjen e seancës kryesore dhe respektimin e principit të kontradiktës së procedurës, që duhet të zbatohen edhe në procedurën për marrjen e sendeve, me obligim që gjykata parashtrësat në njërin anë ti dorëzojë për këqyrje dhe për përgjigje palës së kundërt, duke përfshirë edhe ekspertizat, me atë që do të respektohet principi i barazisë së mjeteve në gjykatën e shkallës së parë dhe në përputhje me aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*Transkop SHA Manastir kundër Maqedonisë së Veriut*) nr.48057/12, § § 29-35, 1 prill 2021).

A r s y e t i m

Sektori i veprave penale, të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 31.01.2022, shqyrtoi për shkresën me Rekomandimin e Byrosë për përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut nr.0901 – 36/1 të datës 25.01.2022, për lëndën (*Transkop SHA Manastir kundër Maqedonisë së Veriut*) nr.48057/12, aktgjykim i GJEDNJ nga 01 prill 2021), për miratimin nga Gjykata Supreme për qëndrim parimor dhe/ose Sektori i veprave penale të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut të nxjerrë konkluzion, me të cilin do të adresohet çështja për mbajtjen e seancës me gojë posaçërisht në procedurën për marrjen e sendeve si dhe obligimin e gjykatave të vendit që ti dorëzojnë shkresat nga njëra anë për këqyrje dhe përgjigje nga ana tjetër, përfshirë edhe ekspertizat e përgatitura sipas urdhrit të gjykatës për respektimin e principit të barazisë së mjeteve.

Në aktgjykimin e theksuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut është konstatuar shkelja e nenit 6 paragrafi (1) nga KEDNJ, për shkak të mos mbajtjes së seancës me gojë në procedurën për marrjen e sendeve dhe mos dorëzimin e ekspertizës nga viti 2011 kompanisë ashtu që e njëjta nuk ka pasur mundësi të njoftohet me përmbajtjen e ekspertizës dhe e njëjta ta komentojë dhe eventualisht ta kontestojë, dhe pas kërkesës të Prokurorit Publik, në vitin 2010 gjyqtari hetues e ka ndërprerë hetimin kundër kompanisë për shkak të mungesës së provave se e njëjta e ka ndërruar numrin e shasisë së automjetit kontestues.

Në përputhje me Rekomandimin e Byrosë për përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Sektori i veprave penale të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 31.01.2022 pas seancës së mbajtur nxori konkluzion se principi i gjykimit të drejtë nënkupton të drejtë për mbajtjen e seancës kryesore dhe respektimin e principit të kontradiktës së procedurës, që duhet të zbatohen edhe në procedurën për marrjen e sendeve, me obligim që gjykata parashtresat në njëërën anë ti dorëzojë për këqyrje dhe për përgjigje palës së kundërt, duke përfshirë edhe ekspertizat, me të cilat do të respektohet principi i barazisë së mjeteve në gjykatën e shkallës së parë, dhe në përputhje me aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*Transkop SHA Manastir kundër Maqedonisë së Veriut*) nr.48057/12, § § 29-35, 1 prill 2021).

Sektori i veprave penale të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, konkluzionin e nxori për përmbushjen e obligimit nga neni 46 nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për përmbarimin e aktgjykimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Sektori i veprave penale